



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of
the Chief State Prosecutor**

**KMLP.I.nr.24/18
Me dt.15.02.2019
Prishtinë**

SH.F /T.H

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Krime të Rënda**

PËR

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

PRISHTINË

Në bazë të nenit 432 par.1 pikat 1.2 dhe 1.3 dhe nenit 433 par.1 dhe 2 të KPPK-së,
brenda afatit ligjor paraqes këtë,

KËRKESË PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.112/18 i dt.25.06.2018 i cili aktvendim ndryshohet me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.681/2018 të dt.18.09.2018 si dhe kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.112/18 i dt.21.09.2018, i ndryshuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1014/2018 të dt.18.10.2018.

Për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3;

- Shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor;

- shkeljes së ligjit penal.

PROPOZJ

Të aprovohet si e bazuar kërkesa dhe konform nenit 438 par.2 të KPPK-së të konstatohet se aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.681/2018 të dt.18.09.2018 si dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1014/2018 të dt.18.10.2018, përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal, apo lëndën ta rikthejë në rivendosje.

ARSYETIM

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.13/2017 të datë 02.05.2018, kundër të akuzuarve; **Emin Beqiri** për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, veprën penale, pengim i të provuarit nga neni 394 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale, moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuari **Rrahim Hashimi** për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së si dhe për veprën penale të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me neni 81 të KPRK-së.

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktvendimin PKR.nr.112/18 të dt.25.06.2018, refuzon kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të akuzuarit Emin Beqiri av.Bajram Tmava si dhe kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit, Rrahim Hashimi, av. Tahir Rrecaj.

Gjykata e Apelit të Kosovës, Departamenti i Krimeve të Rënda,PN.nr.681/18 të dt.18.09.2018, aprovon ankesën e mbrojtësit të pandehurin Emin Beqiri ndryshohet aktvendimi i PKR.nr.112/18 të dt.25.06.2018,ashtu që për të pandehurin Emin Beqiri për shkak të veprave penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, veprën penale, pengim i të provuarit nga neni 394 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale, moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, hedhet aktakuza dhe ndaj të njëjtit pushohet procedura penale në këtë çështje penale për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Në dispozitivin e II të këtij aktvendimi duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe sipas ankesës së mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, - Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.112/18 i datës 25.06.2018 dhe çështja kthehet në rivendosje.

Gjykata Themelore – DKR në Prishtinë, me aktvendimin PKR.nr.112/18 të dt.21.09.2018, refuzon kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të akuzuarin Rrahim Hashimi e ushtruar nga mbrojtësi i tij avokati Tahir Rrecaj.

Gjykata e Apelit të Kosovës, Departamenti i Krimeve të Rënda, PN.nr.1014/2018 të dt.21.09.2018, duke aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi, dhe sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.112/2018 të dt.21.09.2018, ashtu që Gjykata e Apelit aprovon, kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit Rrahim Hashimi dhe për veprën penale, ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së pushohet procedura penale për shkak se nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale. Ndërsa në dispozitivin e dytë të arsytimit të këtij aktvendimi për veprën penale mashtrimi në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, refuzohet ankesa e mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi ashtu që procedura në këtë çështje penalo – juridike vazhdohet sipas dispozitave procedurale të parapara për caktimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me parashtrësën PPS.nr.13/2017 të dt. 19.11.2018, i është drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me propozim që kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.112/18 i dt.25.06.2018 i cili aktvendim ndryshohet me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.681/2018 të dt.18.09.2018 si dhe kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.112/18 i dt.21.09.2018 i ndryshuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.1014/2018 të dt.18.10.2018, të iniciohet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.681/2018 të dt.18.09.2018 si dhe aktvendimin PN.nr.1014/2018 të dt.18.10.2018, **gjeti se :**

Prokurori i Shtetit e mbështet kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, që buron nga neni 432.1.2 dhe 432.1.3 të KPP-së. Ky nen ndërlidhet me nenin 384 paragrafi 1 i KPP-së, ndërsa që neni 384.1.12 e konsideron si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 poashtu të KPP-së.

Krejt kjo ndërlidhje dispozitash kurorëzohet me kërkesat që ka neni 370.7 i KPP-së e që konsiderojmë se paraqet bazën ligjore nga e cila duhet të vendos Gjykata Supremes ngase ky nen thotë që:

370.7. Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Pas shqyrtimit të plotë dhe me vëmendje të aktgjykimeve të të dy shkallëve, është e qartë se dispozita e nenit 370.7 të KPP-së nuk është zbatuar dhe në këtë mënyrë është shkelur edhe neni 7 i KPP-së që detyrimisht obligon secilin organ aktiv në procedurën penale, që

tërësisht dhe saktësisht të vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

Më tutje, janë dy çështje kryesore rreth të cilave prokuroria do të argumentoj përse mendon se aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i gabueshëm dhe i pabazuar.

I

- Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 ndaj të dy të pandehurve: Emin Beqiri dhe Rrahim Hashimi:

- Gjykata e Apelit konstaton se prokuroria nuk ka provuar dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit e sidomos Emin Beqiri, kanë kryer veprat penale për të cilat pretendon prokuroria.
- Poashtu Gjykata e Apelit konstaton se për tu kryer vepra penale e paraparë nga neni 422 i KPRK-së, apo keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, duhet të provohet dashja direkte në lidhje me të pandehurin Emin Beqiri.

1. PROVIMI I DYSHIMIT TË BAZUAR MIRË – shkelja nga neni 432 paragrafi 1 nënparagrafët 2 dhe 3 lidhur me nenin 19.1.12 të KPP-së – aktvendimi i atakuar - aktvendimi PN.nr.1014/2018 të datës 18.10.2018 – konstatimi i Gjykatës së Apelit në faqe 5, pasusi 2, faqe 6 pasusi 2, faqe 7, rreshti 11 lidhur me të dy të pandehurit dhe të gjitha veprat penale të renditura në aktakuzë:

Në aktvendimin PN.nr.1014/2018 të datës 18.10.2018, Gjykata e Apelit bën konstatimin se prokuroria nuk ka provuar dyshimin e bazuar mirë se janë kryer veprat penale të përshkruara në aktakuzën, PPS.nr.13/2017 të datë 02.05.2018.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 12, precizon se dyshimi i bazuar mirë nënkupton ngritjen e aktakuzës. “posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”.

Andaj në vijim, Prokurori i Shtetit do të rendisë të gjitha provat që PSRK pretendon se provojnë dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit e cekur në aktakuzë kanë kryer veprat penale që u vihen në barrë:

- a.) Dëshmitari - i dëmtuari Valmir Hajrullahu deklaron se në data të caktuara dhe vende të caktuara (për më tepër shih aktakuzën), pra më shumë se një herë, është takuar me të pandehurin Rrahim Hashimi, i cili u ka treguar se ky dhe dëshmitari tjetër janë në hetime;
- b.) Po i njëjti dëshmitar ka deklaruar se i pandehuri Rrahim Hashimi u ka kërkuar shumë prej 100,000.00 € në mënyrë që rasti kundër tyre të mbyllet. Sipas këtij

dëshmitari, i pandehuri Rrahim Hashimi kërkesën për ryshfet e ka bërë në emër të të pandehurit tjetër, Emin Beqiri;

- c.) Po ky dëshmitar pretendon se në një rast në zyrën e Rrahim Hashimit ka qenë vet i pandehuri Emin Beqiri dhe i ka thënë dëshmitarit se rasti i hetimeve edhe mund të mbyllet, por është shprehur me fjalët “vetëm dëgjone këtë djalin” (pra duke aluduar në Rrahim Hashimin ndërsa që vet Rrahim Hashimi u thoshte të dëmtuarve se po vepronte në emër të të pandehurit Emin);
- d.) Në lidhje me pikën c, rilexoni edhe njëherë pikat a dhe c dhe bëni ndërlidhjen;
- e.) Po ky dëshmitar, më tutje pretendon se ka qenë në zyre së bashku me dy të pandehurit, pra edhe të pandehurin Rrahim edhe atë Emin, ku kanë biseduar rreth asaj se si rasti i hetimeve kundër QAD-it mund të mbyllet;
- f.) Në rastin konkret, incizimi nuk ka mundur të vërtetojë se i kujt është zëri në video, mirëpo mbeten deklaratimet e dëshmitarëve ¹, dhe ato deklarime janë prova të pranueshme në gjykim;
- g.) Gjykata Supreme tashmë ka trajtuar këtë çështje juridike dhe ka dhënë një aktgjykim precedent nga i cili nuk mund të shmanget askush. Në këtë aktgjykim, vet Gjykata Supreme e thotë se edhe nëse simulimi i veprës penale ka qenë i shpallur me të drejtë si provë e papranueshme, megjithatë janë provat e dëshmitarëve okular të cilat duhet të vlerësohet drejtë nga ana e gjykatës.
- h.) Pikat a, b, c, d, e dhe f, konfirmohen edhe nga dëshmitari i dëmtuari i dytë, Freskim Buqaj;
- i.) Më pas është dëshmia e prindit të dëshmitarit Rexhep Hajrullahu se si janë dhënë 50,000.00 € tek i pandehuri Rrahim Hashimi e në emër të lehtësimit apo mbylljes së rastit kundër djalit të tij që punonte në QAD;
- j.) Pikën h e konfirmon dëshmitari i katërt, prindi i dëshmitarit Freskim Buqaj;
- k.) Të dy dëshmitarët kanë deklaruar poashtu se kanë qenë në zyrën e të pandehurit Emin Beqiri dhe i kanë treguar se i pandehuri Rrahim kishte kërkuar para në emër të tij dhe i kanë thënë “shiko se ka diçka në telefon” (duke aluduar në incizimet);
- l.) Të gjitha këto si më lartë paraqesin prova të drejtpërdrejta dhe duhet të vlerësohen në mënyrë objektive dhe në pajtim me KPP-në, gjatë një gjykimi;
- m.) Më pas është prova rrethanore se telefoni është vonuar disa javë të tëra dhe nuk është dërguar në ekzaminim ndërsa kur është dërguar është konstatuar se disa incizime janë fshirë qëllimisht nga telefoni;

¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 30/2018, e dt. 30.04.2018

- n.) Pra, janë një varg provash të cilat implikojnë të dy të pandehurit dhe të gjitha këto prova, befasisht nga Gjykata e Apelit konsiderohen se nuk e plotësojnë dyshimin e bazuar mirë se është kryer vepra penale;
- o.) Gjykata e Apelit krejtësisht gabimisht konkludon se ka disa dëshmitarë tjerë, sidomos nga radhët e Policisë së Kosovës, ish vartës të të pandehurit Emin Beqiri të cilët konfirmojnë se atë ditë ka pasur bastisje në Gjilan, në një rast tjetër penal dhe për këtë bastisja është kryer një ditë më vonë se urdhri i lëshuar nga GjPP. Përderisa kjo mund të jetë tërësisht e vërtetë, është e paqartë ende se si Rrahim Hashimi e dinte saktë se bastisja do të ndodhë një ditë më vonë, ashtu sikurse edhe kishte ndodhur vërtetë;
- p.) Kështu, Gjykata e Apelit në mënyrë të pabazuar tenton të barazojë vlefshmërinë e provave përmes kuantitetit të numrit të dëshmitarëve. Edhe pse madje edhe kjo mjaft e balancuar, ngase ka disa dëshmitarë që paraqesin prova inkriminuese dhe disa tjerë që paraqesin prova tjera në favor të të pandehurve, Gjykata e Apelit duhet ta dijë se në një rast mund të ketë edhe dhjetëra dëshmitarë në favor të të pandehurit, por mund të jetë e mjaftueshme deklarata e një dëshmitari okular apo një dëshmie të pakundërshtueshme, sikurse mund të jetë gjurma e ADN-së dhe i pandehuri mund të dënohet, edhe vetëm bazuar në një dëshmi të një dëshmitari okular apo gjurme të ADN-së.
2. **Shkelja sipas nenit 432.1.3 lidhur me nenin 431 të KPRK-së – aktvendimi i atakuar – aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN. Nr. 1014/2018 i dt. 18.10.2018, faqe 3, rreshtat 13 – 15 në lidhje me të pandehurin Rrahim Hashimi dhe lidhur me veprën penale - ushtrimi i ndikimit :** Sa i përket konstatimit të gjykatës se vepra penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, nuk ka mundur të ushtrohet për shkak se i akuzuari nuk ka pasur pozitë zyrtare, prokurori i shtetit konsideron se gabimisht dhe në kuptimin e ngushtë gjykata ka interpretuar dispozitën e nenit 431 par.1 të KPRK-së. Dispozita e nenit 431 është mjaftë e qartë dhe për tu kryer kjo vepër penale mund të jetë **“Kushdo”** dhe se nuk kërkon që ky ushtrim patjetër të realizohet nga një person zyrtar. Andaj konsiderojmë se subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person edhe ai i cili ka statusin e personit zyrtar apo të personit përgjegjës, edhe ai që nuk e ka këtë status, pra kushdo apo secili qytetar;
- a.) Gjykata Supreme ka mundësinë unike që të bëj interpretimin e drejtë të kërkesës që të ketë apo jo provim të dashjes, dashjes direkte apo eventuale dhe nga ky interpretim të jetë në harmoni me KPRK-në respektivisht nenet 21 dhe 22 sepse përderisa neni 21 flet për dashjen direkte dhe eventuale, neni 22 i KPRK-së kërkon që dashja (pra ajo direkte apo eventuale) të nxirret nga rrethanat faktike të secilit rast veç e veç. Qëndrimi i Gjykatës Supreme është jashtëzakonisht i rëndësishëm në interpretimin nëse duhet të provohet gjithmonë dashja direkte apo mjafton edhe ajo eventuale ngase ka një numër rastesh tashmë të vendosura nga të gjitha shkallët e gjyqësorit që gjykatat konsiderojnë se prokuroria gjithmonë duhet të kërkoj dashjen direkte dhe vetëm kjo është përcaktuese nëse i pandehuri mund të shpallet fajtor apo jo;

- b.) Për ta ilustruar dashjen direkte apo eventuale po japim një shembull: P.sh. nëse një gjyqtar dëshiron ti jap "leksion" prokurorisë dhe shpall një provë të papranueshme edhe pse është i vetëdijshëm se me këtë po shkel ligjin me dashje ngase e di se prova është në të vërtetë e pranueshme, dashja e tij direkte është në shkeljen e ligjit me keqpërdorim të pozitës zyrtare si gjyqtar, mirëpo dashja indirekte është se ai e din se si pasojë e kësaj shkelje, i pandehuri do të lirohej nga akuza dhe do të përfitonte lirin nga akuza. Pra pavarësisht se nuk ka dashje direkte që i pandehuri të përfitoj me lirin nga akuza, ekziston dashja eventuale dhe ai pajtohet me shkaktimin e një pasoje të tillë;
- c.) Duket që jo rastësisht Gjykata e Apelit nuk e citon komentarin në fjalë ngase po ta bënte një gjë të tillë do të shfaqej haptazi kontradiktore me vetveten sepse përderisa në njërin anë i beson komentarit se i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, apo kërkesës që kjo vepër të kryhet vetëm me dashje direkte, në anën tjetër tek vepra penale e ushtrimit të ndikimit, Gjykata e Apelit në po këtë aktvendim (aktvendimi i GJA-së, PN.mr. 1014/2018 i dt. 18.10.2018), faqe 3, rreshtat 11 - 16, thotë se ushtrimin e ndikimit mund ta bëj vetëm personi zyrtar dhe jo kushdo sikurse përkufizohet në kod. Pra te neni 431 i KPRK-së, apo ushtrimi i ndikimit kërkohet që kushdo mund të jetë kryes i kësaj vepra penale, pra ushtrimin të ndikimit, dhe këtë e thotë edhe vet ky komentari, faqe 1257, pika 1, mirëpo për arsye të cekura si në pikën b, e konsiderojmë këtë komentari si jo obligues për gjykatën;
- d.) Madje në këtë pikë, duhet të theksojmë se Gjykata e Apelit ka tejkaluar autorizimet e saja ligjore sepse nuk mund ta ndryshojë qëndrimin e ligjvënësit. Sepse nëse ligjvënësi ka vënë fjalën "KUSHDO", as Gjykata e Apelit e as kushdo tjetër nuk mund të marrë rolin e ligjvënësit dhe fjalën kushdo ta interpretojë me fjalën "PERSONI ZYRTAR". Interpretimi nga gjykata bëhet në ato raste kur ka dyshime se si mund të interpretohet një nen, mirëpo si ka mundësi që fjala KUSHDO të konsiderohet fjalë e paqartë ?;
- e.) Për këtë ligjvënësi ka qenë i kujdesshëm mjaftueshëm, ngase në nenin 431, pra te ushtrimi i ndikimit përdor fjalën KUSHDO, sepse këtë vepër mund ta kryej secili person, pra pavarësisht nëse është person zyrtar apo jo ndërsa psh. te neni 422 i KPRK-së ka vënë fjalën PERSON ZYRTAR, që dmth se vetëm personi zyrtar mund ta kryejë veprën penale nga neni 422. Një situatë e tillë me formulimin person zyrtar paraqitet edhe në nenin 423, 424, 425, 426, 428 të KPRK-së, etj.
- f.) Në mënyrë tjetër paraqitet situata me nenet 427, 429 (pra marrja e ryshfetit nga personi zyrtar dhe dhënia e ryshfetit nga kushdo), 430 dhe 431 dhe ku këto vepra penale të renditura si më lartë mund ti kryejë kushdo dhe nuk kërkohet që kjo të kryhet vetëm nga personi zyrtar;
- Apo shembulli tjetër: Anëtarët e një BD (Bordi i Drejtorëve) vendosin që një kompani që kishte privatizuar një fabrikë kishte vepruar në pajtim me kushtet speciale të privatizimit. Fabrika e privatizuar kishte të bëjë me prodhimin e tekstilit. Kompania në fjalë kishte privatizuar fabrikën "X" dhe kishte pretenduar

se blerja e një veture të shtrenjtë Mercedes, pastaj blerja e një fabrike tjetër të prodhimit të brumërave (bukës) dhe një banese, ishin investime kapitale në kompaninë "X", që kishte të bëj me prodhimin e tekstilit. Juristët e BD-së sugjerojnë anëtarët e BD-së se investimet e tilla nuk konsiderohen si investime kapitale ngase nuk kanë të bëjnë fare me fabrikën e privatizuar dhe japin opinionin e tyre ligjor se BD nuk duhet të aprovoj investimet e tilla. Aprovimi i investimeve do të nënkuptonte se kompania në fjalë do ta privatizojë përfundimisht fabrikën në fjalë.

BD shpërfill mendimin e juristëve dhe vendos se kompania në fjalë ka përmbushur detyrimet e tyre. Pas kësaj, kompania milionëshe kalon në pronësi të privatizuesve.

Në rastin konkret mbase nuk mund të provohet dashja (direkte) e anëtarëve të BD-së mirëpo mund të provohet elementi i dijenisë (dashja eventuale), me faktin se ata ishin paralajmëruar nga zyrtarët ligjor dhe e kanë pasur të ditur (dijeninë) se veprimi i tyre i caktuar do të sjellë pasojën e caktuar (fabrika do të kaloj në duart e privatizuesit pavarësisht se nuk i ka përmbushur detyrimet e kontratës) dhe ata pajtohen me pasojën e tillë.

II

3. KËRKIMI I DASHJES DIREKTE – shkelja sipas nenit 432.1.3 lidhur me nenin 21 dhe 22 të KPRK-së – aktvendimi i atakuar - aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN.nr. 681/18, i dt. 18.09.2018, faqe 8, rreshti 4-5 lidhur me të pandehurin Emin Beqiri dhe veprës penale – keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422.1 i KPRK-së:

- a.) Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit konsideron se nuk është provuar dashja direkte (aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN.nr. 681/18, i dt. 18.09.2018, faqe 8, rreshti 4-5) dhe me këtë konstaton se tek veprat penale të keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar duhet të provohet dashja direkte. Pra, kjo gjykatë po thotë se vepra penale nga neni 422 mund të kryhet vetëm me dashje direkte???!;
- b.) Po supozojmë se Gjykata e Apelit këtë qëndrim e ka marrë duke u bazuar në Komentarin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, faqe 1211, pika 13. Duhet të kuptohet se ky komentari nuk paraqet obligim për gjykatën dhe nuk mund të merret gjithçka që është shkruar aty si e saktë dhe interpretim i drejtë dhe këtë e kemi sqaruar në tekstin më lartë.

4. AKTVENDIMI I GJYKATËS SË APELIT NË KUNDËRSHTIM ME NENIN 7 TË KPP LIDHUR ME NENIN 432.1.3 – aktvendimi i atakuar – aktvendimi PN.681/18 i dt. 18.09.2018, faqe 7, rreshtat 11 lidhur me të pandehurin Emin Beqiri dhe veprën penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422.1 të KPRK-së:

Gjykata e Apelit jep vlerësim të paqëndrueshëm ligjor dhe të pabazuar në ligj kur merr vendim që aktakuza nuk plotëson dyshimin e bazuar mirë dhe paragjykon veprimin e një prokurori të një rasti. Është paragjykim ngase sipas nenit 7 të KPP-së, të gjitha organet si gjykata, prokuroria dhe policia detyrohen që saktësisht dhe tërësisht ti vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Madje paragrafi 2 i nenit 7 të KPP-së precizon se të tri organet e lartcekura detyrohen që me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe ato që shkojnë në favor të tij. Me fjalë tjera kjo i bie që pas provimit të dyshimit të bazuar mirë, rasti duhet të dërgohet në gjykim dhe më pas vjen faza e vlerësimit të provave dhe në këtë fazë, qoftë në fjalën përfundimtare, qoftë më herët, prokurori i rastit nëse nuk bindet se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se janë kryer veprat penale, ai në bazë të nenit 7 është i obliguar të tërhiqet nga ndjekja penale, ndërsa nëse konsideron se është vërtetuar vepra penale përtej dyshimit të bazuar mirë, ai natyrisht se mbetet pranë aktakuzës dhe kërkon dënimin e të pandehurve sipas ligjit. Mirëpo, në këtë fazë të procedurës penale, Gjykata e Apelit fatkeqësisht ka marrë një rol tjetër dhe ka gjykuar pothuajse rastin, mirëpo çështja qëndron në atë se nuk e ka këtë të drejtë ligjore në këtë fazë të procedurës penale dhe këtë e ka bërë në mënyrë arbitrare ngase ka marrë detyrën që ka trupi gjykues në shkallë të parë, madje edhe kjo vetëm pas dëgjimit dhe shqyrtimit të të gjitha provave në mënyrën e paraparë ligjore me dispozitat e KPP-së që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor.

Nga këto, konsiderojmë se vërtetimi i gabuar dhe jo i saktë i gjendjes faktike ka ndikuar edhe në shkeljen e ligjit penal në rastin konkret.

Nga arsyet e cekura si më lartë, konsideroj se janë plotësuar kushtet për tu ngritur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim, gjykatës së shkallës së parë, Gjykatës Themelore në Prishtinë.

PROKURORI I SHTETIT

Shqipdon Fazliu



2019 MAY 13 PM 2: 19

Pmi.nr.341/2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
DREJTORIA E PROKURORIT
NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPRFEME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit Emin Beqiri, për shkak të veprave penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, pengim i të provuarit nga neni 394 par.2 dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe Rrahim Hashimi, për shkak të veprave penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, dhe të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit e kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.112/2018 datë 25.06.2018 dhe i datës 21.09.2018 si dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018 dhe PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 1 prill 2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit konstatohet se aktvendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018 dhe PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, në pjesën që ka të bëjë me veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së dhe shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së, e në dobi të të pandehurve Emin Beqiri dhe Rrahim Hashimi, e duke mos i prekur vendimet e formës së prerë.

A r s y e t i m i

Në këtë çështje penale Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzës PPS.nr.13/2017 datë 02.05.2018, kundër të pandehurve Emin Beqiri për shkak të veprave penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, pengim i të provuarit nga neni 394 par.2 të KPK-së, dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së,

dhe Rrahim Hashimi, për shkak të veprave penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, dhe të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK.

Gjykata Themelore në Prishtinë – DKR, me aktvendimin Pkr.nr.112/2018 e datës 25.06.2018, ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të pandehurit Emin Beqiri dhe Rrahim Hashimi respektivisht kërkesat e mbrojtësve të tyre.

Gjykata e Apelit të Kosovës - DKR, me aktvendimin PN.nr.681/2018 e datës 18.09.2018, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit Emin Beqiri dhe ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë ashtu që për të pandehurin Emin Beqiri është hedhur aktakuza për veprat penale si më lartë dhe ndaj të njëjtit është pushuar procedura penale për shkak se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer vepra penale për të cilat është dyshuar. Me të njëjtin aktvendim duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit Rrahim Hashimi, është anuluar aktvendimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë - DKR në rivendosje, me aktvendimin PKR.nr.112/2018 e datës 21.09.2018, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të pandehurin Rrahim Hashimi të ushtruar nga avokati i tij Tahir Rrecaj.

Gjykata e Apelit të Kosovës – DKR, me aktvendimin PN.nr.1014/2018 e datës 21.09.2018, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktvendimi e shkallës së parë, ashtu që ka aprovuar kërkesën e mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi dhe për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, ka pushuar procedurën penale për shkak se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale ndërsa për veprën penale mashtrimi në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK, është refuzuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit dhe procedura në këtë çështje penale është vazhduar sipas dispozitave procedurale të parapara për caktimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Kundër këtyre aktvendime Prokurori i Shtetit ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme të konstatoj se aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.681/2018 i datës 18.09.2018, dhe PN.nr.1014/2018 i datës 18.10.2018, përmbajnë shkelje të dispozitave e të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal, apo çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në këtë kërkesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Rrahim Hashimi av. Tahir Rrecaj, me propozim që kërkesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar ose të kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljeve të ligjit.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë Prokurori i Shtetit pretendon se të dy aktvendimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në faktin se në aktvendimin PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, Gjykata e Apelit bënë konstatimin se prokuroria nuk ka provuar dyshimin e bazuar mirë se janë kryer veprat penale të përshkruara në aktakuzë e sa i përket të pandehurit Emin Beqiri. Kështu nga shkresat e çështjes vërtetohet se dëshmitari-i dëmtuari Valmir Hajrullahu ka deklaruar se në datat të caktuara më shumë se një herë është takuar me të pandehurin Rrahim Hashimi i cili u ka treguar se ky dhe dëshmitari tjetër janë nën hetime e po ashtu i njëjti dëshmitar ka deklaruar se i pandehuri Rrahim Hashimi u ka kërkuar shumën prej 100,000.00 €, në mënyrë që rasti kundër tyre të mbyllet dhe se kërkesën e ka bërë në emër të pandehurit tjetër, Emin Beqiri. Më tutje pretendohet se ky dëshmitar ka deklaruar se në zyrën e Rrahim Hashimit ka qenë edhe i pandehuri Emin Beqiri dhe i ka thënë dëshmitarit se rasti i hetimeve mund të mbyllet por është shprehur me fjalët "vetëm dëgjojeni këtë djalë" (duke aluduar në Rrahim Hashimin i cili u thoshte të dëmtuarve se po vepron në emër të pandehurit Emin). Më tutje i njëjti dëshmitar, gjithnjë sipas shkresave, ka pretenduar se ka qenë në zyre së bashku me dy të pandehurit, ku ka biseduar rreth asaj se si rasti i hetimeve mund të mbyllet e cila bisedë është incizuar, por nga incizimi nuk ka mund të vërtetohet se i kujt është zëri por kanë mbet vetëm deklaratimet e dëshmitarëve. Të gjitha këto pretendime janë konfirmuar edhe nga dëshmitari-i dëmtuari i dytë Freskim Buqaj dhe dëshmia e prindit të dëshmitarit Rexhep Hajrullahu i cili dëshmon se si janë dhënë 50,000.00 €, tek i pandehuri Rrahim e në emër të mbylljes së rastit kundër djalit të tij që punonte në QAD, e cila deklaratë konfirmohet nga prindi i dëshmuarit Freskim Buqaj. Të dy dëshmitarët kanë deklaruar se kanë qenë në zyrën e të pandehurit Emin dhe i kanë treguar se i pandehuri Rrahim kishte kërkuar para në emër të tij duke i thënë se ka edhe diçka në telefon (duke aluduar në incizimet e bëra). Të gjitha këto prova janë provat të cilat implikojnë të dy të pandehurit në kryerjen e veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza dhe të cilat prova e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se këto vepra janë kryer. Ndërkaq Gjykata e Apelit gabimisht ka konstatuar, e duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve nga radhët e Policisë së Kosovës, vartës e të pandehurit Emin Beqiri të cilët konfirmojnë se atë ditë ka pas bastisje në Gjilan në një rast tjetër penal dhe për këtë bastisja është kryer më vonë se urdhër i lëshuar nga GjPP. Edhe pse kjo mund të jetë e vërtetë ka mbete e paqartë se si Rrahim Hashimi e dinte saktë se bastisja do të ndodhte një ditë më vonë, ashtu edhe sikurse kishte ndodhur me të vërtetë.

Sa i përket aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, përkitazi me të pandehurin Rrahim Hashimi e për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, Prokurori i Shtetit po ashtu konsideron se gabimisht Gjykata e Apelit ka konstatuar se kjo vepër mund të kryhet nga personi që ka

pozitë zyrtare, njëkohësisht duke i tejkaluar autorizimet e veta dhe duke marrë qëndrimin e ligjdhënësit sepse nëse ligjdhënësi ka thënë se kjo vepër mund të kryhet nga "kushdo" as Gjykata e Apelit e as kushdo tjetër nuk mund ta marrë rrolin e ligjdhënësit dhe këtë fjalë ta interpretojë si "person zyrtar".

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal Prokurori i Shtetit në kërkesë pretendon se gabimisht Gjykata e Apelit konsideron se nuk është provuar dashja direkte me rastin e kryerjes së veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPK-së, sa i përket të pandehurit Emin Beqiri, ndërkaq po ashtu pretendon se është shkelur neni 7 i KPPK-së, sepse Gjykata e Apelit ka dhënë vlerësim të paqëndrueshëm ligjor dhe të pabazuar kur ka marrë vendim që aktakuza nuk plotëson dyshimin e bazuar mirë dhe ka paragjykuar veprimet e një prokurori të rastit. Kjo nga fakti sepse par.2 i nenit 7 të KPPK-së, precizon të tri organet duhet që me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional të vërtetojnë faktet kundër të pandehurve dhe ato që shkojnë në favor të tyre. Pra rasti duhet të dërgohet në gjykim ku dhe bëhet vlerësimi i provave dhe prokurori i rastit nëse bindet se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se janë kryer veprat penale, ai në bazë të nenit 7 të KPPK-së, është i obliguar të tërhiqet nga ndjekja penale. Në rastin konkret Gjykata e Apelit ka marrë rrol të gjykatës gjyquese duke e gjykuar po thuajse në tërësi rastin duke vepruar në mënyrë arbitrare dhe duke marrë kompetencat e trupit gjykues në shkallë të parë.

Andaj, Prokurori i Shtetit konsideron se është shkelur ligji penal në rastin konkret kur është hedhur aktakuza ndaj të dy pandehurve.

Mbrojtësi i të pandehurit Rrahim Hashimi, av. Tahir Rrecaj në përgjigje në kërkesën e Prokurorit të Shtetit konsideron se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar sepse nga përmbajtja e kërkesës, prima facie del se kërkesa i referohet në tërësi vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për çka nuk mund të ushtrohet kërkesa.

Më tutje mbrojtësi thekson se prokurori i shtetit në kërkesë ka propozuar që aktvendimet e kundërshtuar të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje edhe pse një propozim i tillë nuk ka mbështetje ligjore, edhe nën supozimi që Gjykata e Apelit ka bërë shkelje shkeljet e pretenduara. Sido qoftë mbrojtësi konsideron se nëse Gjykata Supreme vlerëson se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet eventuale kjo gjykatë mundet vetëm të konstatojë shkeljet e tilla por jo edhe t'i anulojë aktvendimet e gjykatave më të ulëta.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe përgjigjen e mbrojtësit të pandehurit Rrahim Hashimi, avokatit Tahir Rrecaj nga Prishtina, si dhe duke u mbështetur në shkresat e çështjes konstatoi se me të drejtë Prokurori i Shtetit pretendon se aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018, sa i përket të pandehurit Emin Beqiri dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, sa i përket të pandehurit Rrahim Hashimi, për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, janë të përfshira në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK-së, e lidhur

me nenin 370 par.7 të KPPK-së. Kjo gjykatë gjen se arsyetimi i dhënë në aktvendimet e kundërshtuara është në kundërshtim me shkresat e çështjes dhe atë si më poshtë:

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018, pa të drejtë lëshohet në vlerësim të provave duke i vlerësuar të njëjtat si prova shfajësuese dhe duke marrë në këtë mënyrë rolin e gjykatës së shkallës së parë. Kështu sa i përket dyshimit të bazuar mirë, kjo gjykatë gjen se vlerësimi i Gjykatës së Apelit "se me asnjë provë qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nuk është vërtetuar", është konstatim i tillë dhe vlerësim i cili nuk mbështetet në provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, ashtu siç me të drejtë pretendon Prokurori i Shtetit në mbështetje të mbrojtjes së ligjshmërisë. Kështu në aktvendim sa i përket veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, konstatohet se nga provat të cilat i ka siguruar prokuroria nuk mund të vërtetohet as minimumi i dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se nga këto prova nuk është vërtetuar se i pandehuri Emin ka kërkuar shumën e theksuar nga të dëmtuarit Valmir dhe Freskim, duke konstatuar më tutje se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë. Kjo gjykatë gjen se në shkresat e çështjes janë dëshmitë e dëshmitarit-të dëmtuarit Valmir Hajrullahu i cili deklaron se nga i pandehuri Rrahim Hashimi ka marrë zyra me qira në objektin e hotelit Grand, bashkë me Artan Nimanin kanë aplikuar për një grant në organizatë e tyre e cila kërkesë është refuzuar. I dëmtuari më tutje deklaron se pas 6 muaj pune në Prishtinë, i pandehuri Rrahim Hashimi u kishte treguar se kundër tyre në Departamentin për Hetime Ekonomike është nisur një hetim dhe se për ta përfunduar këtë hetim duhet të jepen 100,000,00 €, duke theksuar gjithnjë se këtë punë e ka në dorë Drejtori i Krimeve Ekonomike (Emin Beqiri), me të cilin ai kishte raporte të mira. Më tutje ka vërejtur se i pandehuri Emin ka shkuar shpesh në zyrën e të pandehurit Rrahim dhe ka vendosur së bashku me të dëmtuarin Freskim që njëri prej tyre të shkonte në zyrën e tij dhe ta incizonte bisedën. Vetë i dëmtuari Valmir kishte shkuar në zyrë të pandehurit Rrahim dhe kur ka pa se ka hy i pandehuri Emin, duke incizuar, e kishte pyetur të pandehurin Emin se çka po bëhej me lëndën e tyre. Atëherë, i pandehuri Emin shkurt kishte thënë "vetëm dëgjojeni këtë djalin", duke menduar në të pandehurin Rrahim. Duke diskutuar dhe duke vlerësuar se çmimi ishte i lartë kishin vendosur që të mos jepnin para dhe të përballen me hetim. Në dëshmi i dëmtuari deklaron se përmes kontakteve me viber me të pandehurin Rrahim kanë biseduar për këtë çështje dhe me datën 31.11.2016 në një komunikim me të përmes whats -up, i pandehuri Rrahim i tregon se nga gjykata është lëshuar urdhëresa për kontroll për datën 01.12.2016 dhe se duhej të jepnin 10,000.00 € që ajo të mos zbatohej. Në të vërtetë urdhëresa është zbatuar me datën 02.12.2016, kur edhe i njëjti është arrestuar bashkë me shokët e tij. Derisa ishin nën masën e arrestit shtëpiak, familjaret e tij pa dijenin e tij të pandehurit Rrahim ia japin 25.000 €, e po ashtu duke qenë në dijeni se i njëjti në këtë çështje thirrej në të pandehurin Emin kanë shkuar në zyrën e tij dhe i kanë treguar se për të janë dhënë para. Pas të gjithave, ka vendosur që rastin ta lajmëroj në polici. Të njëjtën dëshmi e vërteton edhe dëshmitari Freskim Buqaj, e ndaj të cilit po ashtu kanë filluar hetimet dhe i cili e vërteton se i pandehuri Rrahim u kishte kërkuar 100,000,00 €, që kjo çështje të mbyllet dhe se i njëjti i kishte treguar atij

dhe të dëmtuarit Valmir se kishte informata të sigurta nga Departamenti i Hetimit të Krimeve Ekonomike se ata do të arrestoheshin. I njëjti e kishte precizuar se hetimi do të kryhej nga Emin Beqiri dhe Flamur Bllacaku dhe se kontrolli i shtëpisë do të bëhej me datën 1 apo 2 dhjetor 2016. Edhe babai i tij ia kishte dhënë të pandehurit Rrahim 25.000,00 €, që ky hetim të përmbyllej. Nga dëshmia e dëshmitarit Rexhep Hajrullahu-babai i të dëmtuarit Valmir vërtetohet se i njëjti kishte kuptuar se djali i tij Valmiri dhe disa shokë të tij kanë probleme dhe se janë në masën e arrestit shtëpiak. Djali tjetër i tij Fatmiri, i kishte thënë që të kontaktonin me një preson në Hotelin Grand me emër Rrahim Hashimi, i cili në takim i kishte thënë se djali i tij ka probleme me polici dhe se ai ka lidhje me persona të rëndësishëm në pushtet dhe se për të kryer këtë punë duhet t'i jepnin 50.000 €. Edhe pse fillimisht ka kundërshtuar më vonë ka kontaktuar me babanë e Freskimit, Qazim Buqaj, me të cilin janë marrë vesh që së bashku t'i bëjnë 50.000 €, dhe përfundimisht në zyrën e Rrahimit i kanë dhënë 50.000 €, i cili moment është incizuar me telefon. Me kërkesën e tij është përpiluar një shkresë, me shënime personale të pandehurit Rrahim (datëlindja, numri personal) të cilën e kishin nënshkruar ai, Qazimi dhe i pandehuri Rrahim, e në të cilën shkresë është cekur se këto para janë marrë "për përmbylljen e një procesi". Meqenëse procedura nuk kishte përfunduar dhe Valmiri dhe Freskimi kishin mbetur në arrest shtëpiak kanë kërkuar nga Rrahimi që ta përfundon këtë punë ashtu siç janë marrë vesh por i njëjti kishte kërkuar edhe 50.000 €, tjera. Në fund kishte vendosur që vet të takohet me të pandehurin Emin Beqirin me qëllim që nga ai të kuptonte lidhur me rastin dhe pasi ishte takuar me të në zyrën e tij i kishte thënë se kur janë dhënë paratë është përmendur emri yt. I pandehuri Emin kishte këmbëngulur se kjo nuk guxon të ndodhë dhe në zyrën kishte hyrë edhe togeri Nebih Hoti i cili ja kishte shpjeguar se dhënia dhe marrja e rryshfetit është vepër penale e njëjtë. Pasi që edhe nga ky takim nuk kishte marrë ndonjë përgjigje konkrete kishte vendosur që rastin ta praqes në polici ku kishte dorëzuar edhe CD, ku kishte fotografuar rastin kur të pandehurit Rrahim ia kishte dhënë paratë.

Në shkresat e çështjes gjenden një mori transkriptash të mesazheve dhe komunikimeve në mes të dëmtuarit Valmir Hajrullahut dhe Rrahim Hashimit si dhe të Rrahim Hashimit dhe Ibrahim Buqaj dhe të tjerë, nga të cilat vërtetohet se i pandehuri Rrahim ishte në dijeni të plotë për kohën, datën se kur do të bëhet kontrolli i banesave të dëshmitarëve Valmir dhe Freskim, si dhe vërtetohet se i njëjti iu jep udhëzimet e duhura se si duhet të veprojnë dhe se çfarë duhet të bëjnë në rastin konkret, ndërkaq në një bisedë me mesazhe në viber vërtetohet se i pandehuri Rrahim në mes të tjerave thotë "o plako ti e nive edhe vet ata çka tha ndryshe nuk kryhet kjo punë, po ma mirë e ki me pagu dhe vazhdon me punë nuk guxon kush me ta lu", në çka dëshmitari Valmir i përgjigjet "o njeri Emini se ka njetin me dek me qet rast, e këta nuk na u hiqen qafe, edhe skam pare o burrë me pagua harraq me pare të fermerëve tybe edhe ashtu jam mbete mbrapa me punë. Edhe me dashtë skam qysh i arsyetoj tan ato pare", "Rrahimi i përgjigjet "ani plako ti e din ma mirë veç shumë ma shumë kanë met shku nëpër avokatë e ski me muajt me krye punë se si të niset ,djali i Thaçit me kanë sun ta nimoj ma".

Në një bisedë tjetër nga transkripti i datës 29.12.2019, vërtetohet se i pandehuri Rrahim i thotë Ibrahim Buqajt " d.m.th është krejt tjetër nuk mundet për pa u krye kjo pengesë që ky të jetë i lirë..... ky avokati e bënë shkresën dhe këta dy bashkë e dorëzojnë në Drejtorinë e Krimeve Ekomomike dhe komandanti i tyre që është i rrethit të juaj, Emin Beqiri vendos që a kanë të drejtë të punës a jo kështu që është punë e kryer ajo sa i përket punës dhe më tutje i njëjti ju thotë "ditën e mirë t'i mu më thua kur t'i paguash edhe 50.000 € tjera". Në fakt nga transkriptet e bisedave në mes të Valmir Hajrullahut, Rrahim Hashimit, Ibrahim Buqajt etj. vërtetohen se të njëjtit kanë bisedime të gjata lidhur me shumën e parave të dhëna, operacionet të cilat do t'i kryejnë policia ku përmenden shumë emra e në mesin e tyre vazhdimisht përmendet edhe emri i të pandehurit Emin Beqiri si person i cili është në krye të kësaj pune. Të gjitha këto prova të dorëzuara nga prokuroria, dëshmitë e Valmir Hajrullahut, Freskim Buqaj, Qazim Buqaj, Rexhep Hajrullahu, Sranda Dobruna, etj., të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën, nga CD e cila nuk ka mund të deshifrohet si dhe nga telefoni i cili edhe pse është dërguar në ekzaminim nuk ka mund të vërtetohet zëri i të pandehurit Emin, e për të cilat incizime të gjithë deklarojnë në mënyrë të njëjtë se çka ndodhet në to, kjo gjykatë konsideron se pa të drejtë Gjykata e Apelit ka ardhur në konstatim se nuk ka pasur asnjë provë e cila ka involvuar të pandehurin Emin në veprat penale për të cilat është akuzuar. Për më tepër, arsyetimi i dhënë në aktvendimin e kundërshtuar është plotësisht në kundërshtim me provat e cekura dhe me provat të cilat pa të drejtë Gjykata e Apelit i shtjellon dhe i vlerëson si të ishte gjykatë e shkallës së parë. Gjykata e Apelit më tutje anashkalon në tërësi faktin se i pandehuri Rrahim nuk e mohon faktin se ka pranuar shumën prej 36.000 €, duke u thirr në një borxh si dhe duke anashkaluar faktin se në shkresë të nënshkruar nga vet i pandehuri Rrahim, ceket se këto para janë marrë për përfundimin e një procesi, edhe pse i njëjti mohon se nënshkrimi në këtë shkresë është nënshkrimi i tij. Pra gjykata e shkallës së dytë duke e marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë ka pamundësuar që të vërtetohet apo jo fajësia e të pandehurve si dhe vërtetësia apo jo e provave të paraqitura nga prokuroria, e duke i vlerësuar vet provat, edhe pse në mesin e këtyre provave ka pasur prova të cilat e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se këta i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar. Në këtë fazë të procedurës vetëm vlerësohet se a përmbushet minimumi i kërkesës që është dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës dhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë nuk ka mundur të lëshohet në vlerësimin e fakteve kontradiktore e as në fuqinë provuese të këtyre fakteve dhe të konkludoj se i pandehuri nuk është kryes i veprave penale, ngase kjo ka mundur të bëhet vetëm në shqyrtim gjyqësor mbi bazën e parimeve të cilat mundësojnë vlerësimin e drejtë dhe të gjithë anshëm të provave.

Gjykata Supreme gjen se duke e hedhur poshtë aktakuzën dhe duke pushuar procedurën ndaj të pandehurit Emin Beqiri është shkel ligji penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së, në dobi të njëjtit nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës. Njëkohësisht, Gjykata e Apelit ka bërë shkeljen e ligjit penal kur në rrethana të njëjta (në shkelje të njëjta) për një të pandehur (Emin Beqiri) ka ndryshuar aktvendimin, ndërsa për të pandehurin e dytë (Rrahim Hashimi) ka anuluar aktvendimin, edhe pse aktvendimi i shkallës së parë ka qenë i përpiluar për të dy të pandehurit njësoj.

Sa i përket aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, për të pandehurin Rrahim Hashimi dhe veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK, Gjykata e Apelit gabimisht konstaton se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar edhe pse dispozita e nenit 431 par.1 të KPK, qartë përcakton "kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër...., në mënyrë që të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendim marrjen e personit zyrtar....", pra nga kjo dispozitë kushdo mund të kryej këtë vepër penale e jo siç gabimisht ka konstatuar Gjykata e Apelit.

Me këtë Gjykata e Apelit ka shkel ligjin penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së, në favor të pandehurit Rrahim Hashimi kur për këtë vepër penale e ka hedh aktakuzën dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të njëjtit.

Nga të gjitha këto që u tha më lart e duke u bazuar në nenin 438 par.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pml.nr.341/2018, më 1 prill 2019

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj



REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVAN REPUBLIC
SUPREME COURT OF KOSOVO
KOSOVSKI OTPRAVKA POSTARSKA

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi